



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
Departamenti Operacional
Drejtoria e Përpunimit dhe Kontabilitetit të të ardhurave
Sektori i Përpunimit, Vlerësimit dhe Rimbursimit

U D H Ë Z U E S

Nr . 4107 , Datë 22 . 02 .2012

**PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË VERIFIKIMIT TË PASQYRAVE
FINANCIARE PËR VITIN FISKAL 2011**

Hyrje

Në zbatim të ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006 “ Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrave financiare” i ndryshuar”, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nxjerr Udhëzuesin për zbatimin e procedurave të verifikimit të pasqyrave financiare për vitin fiskal 2011 .

Qëllimi i Udhëzuesit është për një administrim dhe verifikim më të mirë të pasqyrave financiare sipas Standarteve të kontabilitetit. Ky udhëzues shërben për t'i orientuar Inspektorët e Vlerësimit në punën e tyre. Për rëndesine që paraqesin pasqyrat financiare vjetore,për situatën e tatimpaguesve si dhe pagesat e detyrimeve tatimore , inspektorët e DPMA-ve, duhet t'i shqyrtojnë me kujdes dhe profesionalizem.

- 1- **Procedura e pranimit të pasqyrave financiare.**
- 2- **Procedura e verifikimit të pasqyrave financiare**
- 3- **Procedurat e shqyrtimit të treguesve të pasqyrave financiare dhe analiza**
- 4- **Pasqyrat sipas standarteve të Kontabilitetit**
- 5- **Dokumentacion shtese i kerkuar ne baze te ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“,neni 60**

1. Procedura e pranimit të pasqyrave financiare.

Procedurat e pranimit të pasqyrave financiare sipas Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit Nr.2 dhe Nr.15 (për Mikrondërrmarjet), formularit të deklarimit dhe të pagesës së tatimit mbi fitimin, si dhe formularit të deklarimit dhe të pagesës së tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël të bëhen sipas kërkesave të ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998, i ndryshuar , udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006 “ Për tatimin mbi të ardhurat”si dhe kërkesave të ligjit Nr.9228, datë 29.04.2004 “ Për kontabilitetin dhe pasqyrave financiare” i ndryshuar”.

Pasqyrat financiare dhe dokumentacioni shoqërues do te dorezohen ne Drejtorinë Rajonale Tatimore perkatese ne tre kopje, nga te cilat nje kopje ne mënyrë elektronike konform ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“.

2.Procedura e verifikimit të pasqyrave financiare.

2.1 Verifikimi formal i pasqyrave financiare të cilat janë: bilanci, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë si dhe aneksi për shpjegimet shpjeguese do të bëhen nga Drejtoria e Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave.

2.2 Drejtoria e Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në Drejtorinë Rajonale Tatimore të azhurnojë listën e të gjithë tatimpaguesve që kanë detyrim ligjor për të plotësuar deklaratën vjetore të tatim fitimit.

2.3 Drejtoria e Përpunimit dhe Menaxhimit të të Ardhurave në Drejtorinë Rajonale Tatimore të azhurnojë listën e tatimpaguesve të biznesit të vogël që kanë detyrim ligjor për të plotësuar deklaratën vjetore të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, si dhe pasqyrat financiare për vitin 2011.

3. Procedurat e shqyrtimit të treguesve të pasqyrave financiare dhe analiza

Objekti i punës do të jetë verifikimi nga zyra sipas orientimeve të mëposhtme por jo vetem:

3.1 Verifikimi i plotësisht të pasqyrave financiare dhe llogaritjet që lidhen me zërat përbërës të tyre.

3.2 Vëmendje do t'i kushtohet verifikimit të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, duke trajtuar me përgjegjësi elementët si më poshte:

- Vlerësimi dhe analiza formale e shpenzimeve për pagat, sigurimet shoqërore e shëndetësore, shpenzimet e qirase duke i krahasuar ato me dokumentacionin bashkëlidhur pasqyrave financiare dhe situatën financiare të deklaruar gjatë vitit 2011 .

- Ndryshimi i gjëndjes së inventarit të produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces , i cili duhet të reflektohet drejtë në të ardhurat e njësisë ekonomike sipas rastit duke pakësuar këto të ardhura kur kemi të bëjmë me pakësim të inventarit, apo rritje të ardhurash kur kemi të bëjmë me shtim inventari(+/-).
- Njohja, vlerësimi, zhvlerësimi dhe paraqitja e inventarit duhet bërë sipas kërkesave ligjore të përcaktuar në SKK Nr.4 dhe 15 si dhe në nenin 23 të ligjit Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.
- Të kontrollohen e krahasohen me kerkesat e ligjit normat e amortizimit të llogaritur,në përputhje me kërkesat e Ligjit “Për tatimin mbi të Ardhurat”.
- Të analizohen shumat e parashikuara për rreziqe (provigjione) afatshkurtra dhe afat gjata duke kontrolluar ne se janë zbatuar drejtë konform Ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.
- Të bëhen verifikimit në se janë pasqyruar saktë rivlerësimet e ndryshme që janë bërë nga subjektet tatimpagues për aktivet afatgjatë materiale dhe aktivet afatgjatë jo materiale gjatë vitit 2011 dhe nese ka, a jane llogaritur sakte amortizimet e tyre sipas ligjit “Për tatimin mbi te ardhurat”.
- Të analizohet me kujdes zëri “Fitimet e pashpërndara” duke vepruar sipas nenit 33/1 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar
- Të analizohen dhe të krahasohen të ardhurat nga shitjet neto dhe nga shitje të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit të deklaruar në pasqyrën financiare përkatëse me atë të deklaruar nga tatimpaguesi në situatën financiare për tvsh, dhe për rastet e tjera kur ka diferenca të evidentohen ato duke kërkuar shpjegimet përkatëse. Për rastet e paargumentuara të bëhen vlerësimet përkatëse.
- Verifikimi i të dhënave të raportuara në pasqyrën e fluksit të parasë.
- Të analizohet humbja ushtrimore dhe humbja e mbartur dhe mënyra e pasqyrimit të saj në deklaratën e tatim fitimit.
- Verifikimi i të dhenave të raportuara në pasqyrën e ndryshimeve në kapital
- Verifikimi i të dhënave të raportuara në aneksin e shënimeve shpjeguese.
- Verifikime të tjera të mundshme, të cilat kanë të bëjnë me SSK, dhe me ligjin Nr.9928, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të cilat gjykohen të nevojshme gjatë procesit të shqyrtimit të pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2011.

3.3 Verifikimi i detyrimeve tatimore te mbartura nga vitet paraardhes, të atyre të llogaritura dhe te derdhura per periudhen ushtrimore te mbyllur, si dhe krahasimi i tyre me gjendjet ne fund te periudhave tatimore (31.12.2011) per cdo lloj tatimi apo takse.

3.4 Llogaritja e raporteve orientuese financiare për periudhen 2011 do të bëhet si më poshtë:

- Të normës së fitimit bruto, neto (fitim para tatimit/xhiros dhe fitim neto/xhiros)

- Të pagesës së TVSH-së / qarkullimit
- Të pagesës së tatim fitimit /qarkullimit
- Të pagesës së sigurimeve shoqërore për numër punonjësish
- Tatimit mbi të ardhurat nga punësimi për numër punonjësish
- Te ardhura per punonjes (xhiro/numrit mesatar mujor te punonjesve)

Analiza e treguesve te lartpermendur te behet ne baze grupimi sipas llojit te veprimtarise psh, ndertim banesa , ndertime publike, tregti mallra ushqimore, tregti mallra industriale, prodhim (gruplojeve te prodhimit, transport mallrash apo udhetaresh, sherbime(sipas llojit sherbimeve

4. Pasqyrat financiare që do të dorëzohen në Drejtoritë Rajonale Tatimore detyrimisht do të jenë të firmosura nga administratori dhe nga hartuesi. Hartuesi i pasqyrave financiare, i cili do të jetë ekonomisti i punësuar apo kontabilisti i kontratuar.

5. Dokumentacion shtesë i kërkuar në bazë të ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 60.

Krahas dorëzimit të pasqyrave financiare konform standarteve të kontabilitetit, tatimpaguesit do të dorëzojnë:

- kontratën e qirasë për ambientet e marra me qera, apo vërtetimin e pronësisë për objektet në pronësi. Inspektorët e vlerësimit do të evidentojnë dhe te kontabilizojne detyrimet e tatimit mbi qeranë për objektet e marra me qera. Per detyrimin e papaguar te behet llogaritja dhe kontabilizimi i kamatëvonesave dhe gjobave konform ligjit nr.9920 date 18.05.2008 “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqiperise”.
- Pasqyrën e qarkullimit të likuiditeteve (cash-flow)
- Gjendjen e inventarit te materialeve dhe mallrave me date 31.12.2011 (analitik). Tatimpaguesit te cilet kane numer te konsiderushem artikujsh iventarin mund ta dorezojne elektronikisht te shoqeruar me shkrese zyrtare.
- Inventarin e mjeteve te transportit ne pronesi
- Pasqyra e aktiveve afatgjata materiale
- Deklarimin ne lidhje me pjesemaresit ne kapitalet e shoqerise, kontabilistin ose zyren kontabel dhe ekspertin kontabel, ne qoftese ploteson kriteret ligjore per audit nga eksperti.
- Një kopie të raportit të ekspertit kontabël të autorizuar për shoqëritë që e kanë të detyruar ekspertizën sipas legjislacionit në fuqi.

Për verifikimet e mësipërme do të mbahen proces verbale si dhe do të plotësohet skeda e verifikimit formal të të dhënave të bilancit të vitit 2011 sipas formatit bashkëlidhur për çdo pasqyrë financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të shqyrtuar duke e krahasuar me rentabilitetin më të lartë të konstatuar për grupin ekonomik.


Kjo analizë do të shërbejë për verifikime të mëtejshme të deklarimeve të tatimpaguesve për detyrimet tatimore si dhe për vlerësimin e detyrimeve të parapagimeve të tatimit mbi fitimin.

Të dhënat nga shqyrtimi paraprak i pasqyrave financiare, sidomos për tatimpagues me humbje, normë të ulët rentabiliteti, si dhe tatimpagues të cilat gjykohen për verifikime të mëtejshme të deklarimeve në vend, të evidentohen dhe të dërgohen për ndjekje të mëtejshme Drejtorisë së Kontrollit Tatimor

Drejtorët e Drejtorive të Menaxhimit të të Ardhurave të marrin masat e duhura për zbatimin e detyrave të mësipërme.

Për shkeljet që do të konstatohen si dhe për moszbatimin e orientimeve të këtij udhëzuesi personat përgjegjës do të mbajnë përgjegjësi administrative.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
GAZMIR SPAHËJA



PROCES- VERBAL

I mbajtur sot më datë _____ 2012, në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve _____ për shqyrtimin e pasqyrave financiare 2011, të tatimpaguesit _____, me NIPT _____, me administrator ose person fizik _____, me aktivitet _____, për mangësi të gjetura në kontrollin e _____.

Nga shqyrtimi i pasqyrave financiare u konstatuan problemet e mëposhtme:

Për mangësitë e përmendura në këtë proces verbal mendojmë se është shkelur:

Për DPMA _____

Evidenca e kontabilistev dhe eksperteve kontabël

Nr	Shoqëria	Nipti	Aktiviteti	Inspektori I DRT	Hartuesi I Pasqyrave financiare		Eksperti
					Ekon I punesuar	Kont.miratuar	
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

Inspektori

Pergjegjesi I Sektorit

Drejtori I DPMA-se

Subjekti _____
NIPT

Inventari automjeteve ne pronesi te subjektit 31.12.2011

Nr.	Lloji automjetit	Kapaciteti	Targa	Vlera
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
etj				

Shoqeria _____
 NIPTI _____

Aktivitet Afatgjata Materiale me vlere fillestare 2011

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje	Shtesa nga rivleresimet	Shtesa	Pakesime	Gjendje
			1/1/2011				12/31/2011
1	Toka						0
2	Ndertime						0
3	Makineri,paisje						0
4	Mjete transporti						0
5	kompjuterike						0
1	Zyre						0
2							0
3							0
4							0
	TOTALI		0		0	0	0

Amortizimi A.A.Materiale 2011

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje	Shtesa nga rivleresimet	Shtesa	Pakesime	Gjendje
			1/1/2011				12/31/2011
1	Toka		0		0		0
2	Ndertime						0
3	Makineri,paisje,vegla						0
4	Mjete transporti						0
5	kompjuterike						0
1	Zyre						0
2							0
3							0
4							0
	TOTALI		0		0	0	0

Vlera Kontabel Neto e A.A.Materiale 2011

Nr	Emertimi	Sasia	Gjendje	Shtesa nga rivleresimet	Shtesa	Pakesime	Gjendje
			1/1/2011				12/31/2011
1	Toka		0			0	0
2	Ndertime						0
3	Makineri,paisje,vegla						0
4	Mjete transporti						0
5	kompjuterike						0
1	Zyre						0
2							0
3							0
4							0
	TOTALI		0		0	0	0

Administratori

	Aktiviteti	Te ardhurat nga aktiviteti
1	Tregti	Tregti karburanti
2	Tregti	Tregti ushqimore pije
3	Tregti	Tregti materiale ndertimi
4	Tregti	Tregti cigaresh
5	Tregti	Tregti artikuj industrial
6	Tregti	Farmaci
7	Tregti	Ekspert mallrash
8	Tregti	Tregti te tjera
I		Totali i te ardhurave nga tregtia
9	Ndertim	Ndertim banese
10	Ndertim	Ndertim pune publike
11	Ndertim	Ndertime te tjera
II		Totali i te ardhurave nga ndertimi
12	Prodhim	Ekspert, prodhime te ndryshme
13	Prodhim	Fason te cdo lloji
14	Prodhim	Prodhim materiale ndertimi
15	Prodhim	Prodhim ushqimore
16	Prodhim	Prodhim pije alkolike, etj
17	Prodhim	Prodhime energji
18	Prodhim	Prodhim hidrokarbure,
19	Prodhim	Prodhime te tjera
III		Totali i te ardhurave nga prodhimi
20	Transport	Transport mallrash
21	Transport	Transport malli nderkombetare
22	Transport	Transport udhetaresh
23	Transport	Transport udhetaresh nderkombetare
IV		Totali i te ardhurave nga transporti
24	Sherbimi	Sherbime financiare
25	Sherbimi	Siguracione
26	Sherbimi	Sherbime mjekesore
27	Sherbimi	Bar restorante
28	Sherbimi	Hoteleri
29	Sherbimi	Lojra Fati
30	Sherbimi	Veprintari televizive
31	Sherbimi	Telekomunikacion
32	Sherbimi	Ekspert sherbimish te ndryshme
33	Sherbimi	Profesione te lira
34	Sherbimi	Sherbime te tjera
V		Totali i te ardhurave nga sherbimet
		TOALI (I+II+III+IV+V)

Te punesuar mesatarisht per vitin 2010:	Nr. i te punesuarve
Me page deri ne 19.000 leke	
Me page nga 19.001 deri ne 30.000 leke	
Me page nga 30.001 deri ne 66.500 leke	
Me page nga 66.501 deri ne 84.100 leke	
Me page me te larte se 84.100 leke	
Totali	

Administratori

Shenim: Kjo pasqyre plotesohet edhe on-line.

DREJA E VERIFIKIMIT FORMAL TE TE DHENAVE BILANCI VITI 2011

SUBJEKTI:				
NIPT:				
AKTIVITETI:				
ADRESA:				
ADMINISTRATORI:				
FINANCIERI:				
BILANCI NR.:	PROT.	DATE	/ / 2012	
RAKORDIMI I DEKLARATES PER FUNDIMTARE TE TATIM FITIMIT ME TE DHENAT E BILANCIT				
TREGUESIT	BILANCI	DEKLARATA	DIFERENCA	SISTEMUAR
TE ARDHURAT				
SHPENZIMET				
SHPENZIMET E PAZBRITSHME				
HUMBJA E MBARTUR				
RAKORDIMI I TE ARDHURAVE TE BILANCIT ME SITUATEN FINANCIARE PER TVSH				
TREGUESIT	BILANCI	SIT.FINANCIARE	DIFERENCA	SHPJEGIME
SHITJE TE TATUSHME				
EKSPORTE				
SHITJE TE PERJASHTUARA				
QARKULLIMI TOTAL				
RAKORDIMI I SHPENZIMEVE TE PERSONELIT ME SITUATEN FINANCIARE SIGURIME SHOQERORE				
TREGUESIT	BILANCI	SIT.FINANCIARE	DIFERENCA	SHPJEGIME
FONDI I PAGES				
SIGURIME SHOQERORE				
Nr.mes I PUNONJESVE				
KRAHASIMI I PAGESES SE DETYRIMEVE TATIMORE ME VITIN E KALUAR				
TREGUESIT	2010	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
RAP.TVSH / XHIRO				
RAP.T.FITIMI / XHIRO				
RAP.FONDI I PAGES / XHIRO				
RAP.SIGURIME SHOQERORE/XHIRO				
VERIFIKIMI I NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN				
TREGUESIT	2010	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
KAPITALI AKSIONER				
TOTALI I KAPITALIT				
VERIFIKIMI I NDRYSHIMEVE TE AKTIVEVE AFATSHKURTA				
TREGUESIT	2010	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
IVENTARI				
PRODHIM NE PEROCES				
PRODUKT I GATSHEM				
VERIFIKIMI I NDRYSHIMEVE TE AKTIVEVE AFATGJATA				
TREGUESIT	2010	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
AKTIVE AFATGJATA MATERIALE				
AKTIVE BIOLOGJIKE				
AKTIVE JOMATERIALE				
KRAHASIMI I RENTABILITETIT DHE NORMES SE FITIMIT				
TREGUESIT	2010	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
RENTABILITETI				
NORMA E FITIMIT				
VERIFIKIMI I TE DHENAVE TE CASH FLOW				
TREGUESIT	2010	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
GJENDJA NGA VITI KALUAR				
GJENDJA NE FILLIM TE VITIT			0	
KLIENTE PER SHITJE E SHERBIME			0	
ARKETIME NGA SHITJA				
SHITJET NETO NGA BILANCI + TVSH E SHITJEVE				
DIFERENCA E SHITJEVE TE DEKLARUARA			0	
KRAHASIMI I LLOGARITJES TE AMORTIZIMIT ME VITIN E KALUAR				
TREGUESIT	2010	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
AMORTIZIMI				
KRAHASIMI I RENTABILITETIT ME MESATAREN E INDUSTRISE				
TREGUESIT	MES.INDUSTRISE	2011	DIFERENCA	SHPJEGIME
RENTABILITETI				
KONSIDERATA TE PERGJITHSHME MBI TE DHENAT E BILANCIT				

PERGJ.SEK.VLERSIMIT

INSPEKTORI VLERSIMIT

DREJTORI I VLERSIMIT